



GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË Gjyqtari individual Faton Bajrami në çështjen juridike të propozueses - paditëses B... Sh.a, me seli ne Prishtinë, me nr.identifikues, me nr te regj. te biznesit, të cilën e përfaqëson me autorizim S.B dhe I.Q qe te dyte jurist te dip., kundër të paditurave 1. NTP “P...” S.V BI, 2. N.T “P1...” A.V B.I dhe 3. N.T.Sh. “D...” E.B B.I qe te tre me seli ne Gjilan, te cilat sipas autorizimit i përfaqëson E.Q avokat nga Gjilani dhe R.I, komuna e Gjilanit, me objekt kontesti për kthimin e borxhit, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës të ushtruar nga pala paditëse, kundër aktgjykimit të formës se prerë, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.144/13 te datës 05/05/2017, i cili ka marre forme te prere me date 06.07.2017 dhe i permbarueshem me date 14.07.2017, me datën **01/09/2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pa themeltë propozimi për përsëritjen e procedurës i ushtruar nga paditësja B... Sh.a, me seli ne Prishtine, kundër aktgjykimit të formës se prerë, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.144/13 te datës 05/05/2017, i cili ka marre forme te prere me date 06.07.2017 dhe i përmbareueshem me date 14.07.2017.

A r s y e t i m

Paditësja B... Sh.a, me seli ne Prishtinë, me datën 17/06/2021, ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën e shkallës së parë, kundër aktgjykimit të formës se prerë, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.144/13 te dates 05/05/2017, i cili ka marre forme te prere me date 06.07.2017 dhe i perbarueshem me date 14.07.2017, me arsyetim se janë paraqitur prova të reja, të cilin propozim e ka bazuar në nenin 232 pika g). nenin 233.1, nenin 235 dhe 240 te LPK-së, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovon propozimin dhe të lejon përsëritjen e procedurës si dhe të abrogoj aktgjykimet e atakuar.

Përgjigje në propozim nuk kane paraqitur te paditurat edhe pse me date 08.10.2021, kane pranuar propozimin e pales paditese, permes te autorizuarit te tyre.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, me kujdes të shtuar bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës, në harmoni me dispozitat e nenit 239 paragrafi 1 e lidhur me nenin 235 të LPK-së dhe pas vlerësimit të thënieve të paraqitura në propozim, gjeti se:

-Propozimi është i pa themeltë.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit ka vendosur të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses B... dhe ka detyruar të paditurat 1. NTP “P...”, 2. N.T “P1...” dhe 3. N.T.Sh. “D...” qe te tre me seli ne Gjilan që paditëses t’ia paguajnë borxhin në shumë prej 166,132.10 euro, me kamatë të cilat e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e datës 21/03/2013 e deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto në afat kohor prej 7

ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë si të pabazuar në shumën prej 368,755.11 euro, kurse në pikën III ka konstatuar se paditësja e ka tërhequr padinë ndaj të paditurit Raif Isufi nga Gjilani si dhe në pikën IV. ka vendosur që secila palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

Aktgjykimi i atakuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.144/13 i datës 05/05/2017, ka marrë formë të prerë me datë 06.07.2017 dhe është i përmbartueshëm nga data 14.07.2017.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, në raport me pretendimet e palës paditëse për përsëritjen e procedurës, ka ardhë në përfundim se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara sipas nenit 232 pika g) e LPK-së, që të lejohet përsëritja e procedurës në këtë çështje juridike, për arsye si vijon: Sipas kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi ka paraparë se, në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, e që sikur t'i dinte këto fakte ose t'i kishte parashtruar këto prova në procedurë të mëparshme, do të nxjerrët një vendim më favorshëm për të. Kusht është që këto fakte të kenë ekzistuar para përfundimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë, por që këto fakte nuk kanë qenë të ditura për palët. Në rastin konkret provat të cilat i ka bashkangjitur pala paditëse në propozimin për përsëritjen e procedurës, të njëjtat kanë qenë të ditura për palën paditëse qysh me 21.10.2005, e njëjta rezulton dhe vete pohon të jete hartuese e tyre, ku në deklaratën e të paditurave (të prezantuar si prove të re, me qëllim të përsëritjes së procedurës) është e vendosur llogo e paditëses, numri i protokollit, data e dhënies së deklaratës, e në aneks të saj janë nënshkrimet e anëtareve të komitetit ekzekutiv të saj, mbi këtë bazë gjykata konstaton se bazuar në pretendimet e palës paditëse të dhëna në propozim për përsëritje të procedurës, në rastin konkret nuk është paraqitur asnjë provë e re në bazë të së cilës për palën paditëse do merrej ndonjë vendim më i favorshëm, pasi që kjo prove tanimë ka ekzistuar para inicimit të procedurës kontestimore, sipas padisë së datës 21.03.2013, e po ashtu gjykata konstaton se kjo prove e cila tanimë ka ekzistuar, ka qenë e ditur për palën paditëse dhe ka mund të paraqitet së bashku me provat e tjera të dosjes së borxhit, sipas kredisë kur është iniciuar procedura kontestimore, sikurse të gjitha provat tjera me të cilat janë vërtetuar pretendimet në padi dhe për këtë gjykate (Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë) nuk është i pranueshëm pretendimi i palës paditëse që të bartë fajin të organet e hetuesisë, me arsyetimin se kjo prove është marrë nga ana e tyre.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë konform nenit 239 paragrafi 1, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.818/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtari individual
Faton Bajrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 7 ditësh, prej ditës së dorëzimit, trupit gjykues të Gjykatës së Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, sipas nenit 240.4 të LPK-së.